

Raporti Vjetor 2025 i Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë (ECRB)

Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë (ECRB) ka publikuar Raportin Vjetor, i cili pasqyron hapat e rëndësishëm të ndërmarrë nga vendet e rajonit drejt integritetit të tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit me tregjet evropiane, forcimit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe rritjes së transparencës në tregjet me shumicë.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) vazhdon të luajë një rol proaktiv në këtë proces, duke përfaqësuar Shqipërinë në të gjitha strukturat dhe proceset vendimmarrëse rajonale. Grupi i Punës për REMIT, në kuadër të angazhimit të ERE-s në ECRB, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Elton Radheshi, gjatë vitit ka zhvilluar një veprimtari të fokusuar në parandalimin e manipulimeve të tregut, harmonizimin e procedurave hetimore, mbrojtjen e të dhënave dhe përafrimin e kuadrit rregullator kombëtar me rregulloret dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Raporti i ECRB-së tregon progresin e bërë në kuadër të integritetit të tregut me shumicë të energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor, ku Shqipëria është angazhuar në mënyrë aktive në proceset e bashkimit të tregjeve të ditës në avancë dhe brenda ditës (Market Coupling), si dhe në zbatimin e Paketës për Integritetin e Elektricitetit. Në të njëjtën kohë, vëmendje e veçantë i është kushtuar funksionimit të tregut me pakicë dhe mbrojtjes së konsumatorëve, duke evidentuar nevojën për liberalizim të mëtejshëm, lehtësimin e procedurave për ndërrimin e furnizuesit dhe zgjerimin e përdorimit të matjes inteligjente. Nëpërmjet angazhimit të saj në ECRB, ERE vijon të jetë e angazhuar për garantimin e një tregu energjetik transparent, eficient dhe të sigurt, që mbron interesat e konsumatorëve shqiptarë dhe kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Në planin institucional, ECRB raportoi përmbushjen e plotë të detyrimeve të tij ligjore gjatë vitit 2025. Aktivitetet përfshinë 23 takime pune, 17 raporte dhe produkte të tjera, si dhe një bashkëpunim të zgjeruar me autoritetet rregullatore evropiane.

Në sektorin e energjisë elektrike, ECRB realizoi, për herë të parë, monitorimin e zbatimit të Kodit të Rrjetit për Kërkesat për Lidhjen e Gjeneratorëve (NC RfG) në të gjitha Palët Kontraktuese. Vlerësimi evidentoi nivele të ndryshme progresi në zbatim dhe përafrim të kuadrit rregullator. Paralelisht, vijoi puna për hartimin dhe përmirësimin e metodologjive e tarifave të transmetimit dhe shpërndarjes, transparencën e të dhënave të tregut dhe integritetin në proceset Single Day-Ahead Coupling dhe Single Intraday Coupling.

Në tregjet me pakicë, kërkesa për energji elektrike në Palët Kontraktuese u rrit mesatarisht me 1.71% në vitin 2024. Çmimet mesatare për klientët fundore u ulën me 2% për familjet dhe 9% për industrinë, ndërsa raporti evidenton vijimin e subvencionimit të kryqëzuar, përqendrimin e lartë të tregjeve, normat e ulëta të ndryshimit të furnizuesit dhe mangësi në fuqizimin e konsumatorëve.

Në sektorin e gazit, raporti evidenton se zbatimi i plotë i kodit të balancimit nuk është realizuar ende në asnjë Palë Kontraktuese. Në këtë kuadër, ECRB rekomandon që alokimi i përbashkët i kapaciteteve në pikat e interkonjeksionit të bëhet praktikë standarde deri në vitin 2026, me synim forcimin e integritetit ndërkufitar dhe sigurisë së furnizimit. Në fushën e infrastrukturës energjetike, ECRB vendosi dhe publikoi treguesit Unit Investment Cost (UIC), duke krijuar një bazë të standardizuar për krahasimin e kostove të investimeve të investimeve dhe për forcimin e vlerësimit rregullator të projekteve të infrastrukturës dhe Projects of Energy Community Interest (PECI).

Në përfundim, Raporti Vjetor i ECRB-së evidenton përparimin e mëtejshëm drejt integritetit të tregjeve energjetike të Komunitetit të Energjisë me tregun evropian, ndërsa njëkohësisht thekson nevojën për forcimin e konkurrencës, transparencës, mbrojtjes së konsumatorëve dhe kapaciteteve rregullatore. Në këtë kuadër, raporti evidenton rëndësinë e vijimit të përafrimit të kuadrit rregullator me standardet evropiane, forcimit të integritetit dhe transparencës së tregjeve, si dhe të mbrojtjes dhe fuqizimit të konsumatorëve.